



SCHULPSYCHOLOGIE
BILDUNGSBERATUNG

Albanisch

***Konsultorja e
psikologjisë
shkollore dhe
e arsimit***

informon mbi

***Drejtimit
arsimore në
Austri***

1

SHKOLLAT E DETYRUESHME TË KULTURËS SË PËRGJITHSHME

Detyrimi shkollor:

Detyrimi shkollor vlen për të gjithë fëmijët me qëndrim të përhershëm në Austri. Ai fillon me 1 shtator pas mbushjes së moshës 6 vjeçare dhe vazhdon nëntë vjet shkollorë. Detyrimi i përgjithshëm shkollor plotësohet me ndjekjen e tipeve shkollore të shënuara më poshtë:

- Në katër vjet shkollorë të parë nëpërmjet ndjekjes së shkollës fillore (Grundschule [Volksschule]) ose të shkollës speciale;
- në vitin e 5-të deri në vitin e 8-të shkollor nëpërmjet ndjekjes së ciklit të lartë të shkollës tetëvjeçare (Hauptschule, Volksschuloberstufe), të ciklit të ulët të shkollës së mesme të përgjithshme (allgemeinbildende höhere Schule) ose të ciklit të lartë të shkollës speciale (Sonderschuloberstufe);
- në vitin e 9-të shkollor nëpërmjet ndjekjes së shkollës politeknike, vazhdimit të shkollës fillore, të ciklit të lartë të shkollës tetëvjeçare ose të shkollës speciale ose nëpërmjet ndjekjes së një shkolle të ulët profesionale ose të një shkolle të mesme.

Shkolla fillore (mosha 6 deri në 10 vjeçare)

Të gjithë fëmijët me detyrim shkollor duhet të regjistrohen nga personat me të drejtë kujdestarie mbi ta në shkollën fillore përkatëse.

- Në përputhje me prirjet ose nevojat e fëmijës, ai mund të ketë nevojë për përbalimin e qëllimeve të së mesuarit të shkollës bazë I deri në 3 vjet. Në këtë rast, këto forma të organizimit janë të mundshme: Fëmijët që sipas vlerësimit të drejtorit (të drejtoreshes) së shkollës ose të mësuesit (të mësueses) së klasës do të kenë nevojë për 3 vjet për përvetësimin e shkollës bazë I (viti i 1-rë dhe i 2-të shkollor, në rast nevojës klasa parashkollore) do të mësojnë sëbashku me fëmijët e vitit të 1-rë shkollor ose të 1-rë dhe të 2-të shkollor ose do të përfshihen që nga fillimi ose gjatë vitit të parë në klasa parashkollore të ndara nga pikëpamja e organizimit.
- *Pranimi paraprak:* Fëmijët që mbushin moshën gjashtëvjeçare vetëm nga 1 shtator deri më 31 dhjetor të vitit shkollor vijues dhe që nuk do të mbingarkohen me kërkesat e vitit të 1-rë shkollor mund të pranohen më përpara në vitin e 1-rë shkollor, në qoftë se prindërit bëjnë kërkesën përkatëse.
- Nga viti shkollor 1998/99 parashikohet në programin e shkollës fillore një gjuhë e huaj e gjallë nga viti i 1-rë shkollor si ushtrim i detyrueshëm (d. m. th. pa notë). Në rastin e vështirësive të organizimit në disa shkolla mund të ekzistojnë rregulla tranzicioni deri në vitin shkollor 2002/2003. Ushtrimi i detyrueshëm "Gjuha e huaj e gjallë" duhet të ekzistojë patjetër në të gjitha klasat e shkollave fillore nga fillimi i vitit shkollor 2003/2004.
- *Vazhdimi i përgatitjes shkollore:* Në vitin e 4-të shkollor personat me të drejtë kujdestarie informohen pak kohë para mbarimit të semestrit të 1-rë ose në fillim të semestrit të 2-të të vitit shkollor kundrejt një dëshmie mbi vazhdimin e këshillueshëm të përgatitjes shkollore të nxënës(e)ve në përputhje me interesat dhe rendimentet e tyre. Kusht për pranimin në ciklin e lartë të shkollës tetëvjeçare (Hauptschule)

është mbarimi i suksesshëm i vitit të 4-të shkollor. Kushte të tjera pranimit nuk ka, sepse ndarja në grupe të ndryshme rendimentale bëhet *pas një periudhe vëzhgimi* në vetë ciklin e lartë të shkollës tetëvjeçare.

Për kushtet e pranimit në një shkollë të mesme të përgjithshme shih pikën 2, "Hyrja në klasën e 1-rë".

(Informacione mbi shkollën fillore [Volksschule] në Internet nën: <http://www.bmbwk.gv.at/pbildg/allgbdg/volkss.htm>)

Cikli i lartë i shkollës tetëvjeçare (mosha 10 deri në 14 vjeçare)

Cikli i lartë i shkollës tetëvjeçare është i integruar në komunën përkatëse dhe mund të merret me mjaft fleksibilitet me nevojat e ndryshëm të nxënësve dhe të nxënësve (sipas zonës, interesave dhe prijëve kryesore etj.).

- Në lëndët "gjeranishtja", "matematika" dhe "gjuha e huaj e gjallë" ka grupe të ndara sipas rendimentit që e bëjnë të mundshme që aftësitë e nxënësve dhe të nxënësve të merren parasysh me synim të caktuar. Në këtë rast mësimi bëhet sidomos në grupe të vogla. Kërkesat e grupit rendimental më të lartë u përshtaten atyre të shkollës së mesme të përgjithshme.

- Në të gjitha lëndët e detyrueshme ekziston mundësia e një mësimi nxitës special, që shfrytësohet shpesh sidomos në lëndët me ndarje sipas rendimentit.

- Çdo shkollë ka mundësinë për ta orientuar brenda njëfarë kufiri ofertën e saj në lëndët e mësimi veçanërisht sipas situatës së saj. Në këto kushte ajo mund të vendosë edhe programe të veta të mësimi në kuadrin e autonomisë së shkollës. Në këtë mënyrë do të krijohen qendra me një profil ose specialitet të veçantë (p. sh.: me gjuhë të huaja, kreativitet artistik, sport, shkenca natyrore dhe teknikë, ekologji, informatikë etj.).

- Përveç kësaj ka forma të veçanta të ciklit të lartë të shkollave tetëvjeçare (Hauptschulen) në fushën sportive dhe artistike.

Në klasën e 3-të dhe të 4-të i kushtohet vëmendje e veçantë pyetjes së vazhdimit të përgatitjes shkollore dhe profesionale të të rinjve. Kjo realizohet në kuadrin e ushtrimit të detyrueshëm "Orientimi profesional", të ditëve të veçanta që i kushtohen praktikës profesionale, të vizitave mësimore dhe të ekskursioneve.

Në rast të një suksesi të mjaftueshëm për këtë në ciklin e lartë të shkollës tetëvjeçare, ekziston mundësia e kalimit direkt në një shkollë të mesme të përgjithshme dhe të ulët ose të mesme profesionale.

(Informacione mbi ciklin e lartë të shkollës tetëvjeçare [Hauptschule] në Internet nën: <http://www.bmbwk.gv.at/pbildg/allgbdg/haupts.htm>)

Integrimi i fëmijëve me nevoja pedagogjike të veçanta në sistemin e shkollave të zakonshme

Mësimi integrues dhe edukata integruese ua japin fëmijëve me edhe pa të meta përvojën e të mësuarit të përbashkët. Fëmijët me nevojë për nxitje në kuadrin e pedagogjisë speciale mund të mësojnë të integruar në shkollën fillore (Grundschule), në ciklin e lartë të shkollës tetëvjeçare (Hauptschule) dhe në ciklin e ulët të shkollës së mesme të përgjithshme (Unterstufe der allgemeinbildenden höheren Schule).

Shkolla speciale (mosha 6 deri në 15 vjeçare):

Shkolla speciale përbëhet nga tetë, në rastin e përfshirjes së shkollës politeknike ose të një kursi për përgatitjen profesionale, nëntë vjet shkollorë.

Sistemi i shkollave speciale austriake ka dhjetë degë.

Nxënësit/Nxënëset marrin nëpërmjet mësues(e)ve të shkollave speciale veçanërisht të përgatitur(a) dhe metodave individuale të mësimit një përgatitje të përgjithshme bazë që të aftësohen për përballimin e përgatitjes së mëtejshme profesionale ose për ndjekjen e shkollave më të larta.

● Shkollat speciale me një program mësues të vet:
shkolla speciale e përgjithshme (për fëmijë me të meta në rendiment dhe të dobët në mësime), shkolla speciale për fëmijë të verbër, të shurdhët dhe me të meta shumë të rënda.

● Shkollat speciale ku mësohet mbi bazën e programit mësues të shkollës fillore (Volksschule), të ciklit të lartë të shkollës tetëvjeçare (Hauptschule), të shkollës politeknike ose të një shkolle speciale të një tipi tjetër:

shkollat speciale për fëmijë me të meta fizike, gjuhësore, të shikimit, të dëgjimit dhe me vështirësi në edukim; shkollat e qëndrave kurative.

(Informacione të tjera mbi pedagogjinë speciale në Internet nën:
<http://www.bmbwk.gv.at/pbildg/allgbdg/sonders.htm>)

Shkolla politeknike (mosha 14 deri në 15 vjeçare):

Shkolla politeknike vijon pas vitit të 8-të shkollor dhe përbëhet nga një vit shkollor. Nxënësit dhe nxënëset përgatiten për jetën e mëtejshme, sidomos për jetën profesionale, nëpërmjet thellimit të kulturës së përgjithshme, të orientimit profesional dhe të përgatitjes profesionale bazë. Një fazë orientimi në fillim të vitit shkollor dhe orientimi profesional si synim parimor i të gjitha lëndëve mësimore ofrojnë mundësi të larmishme për njohjen e botës profesionale. Nëpërmjet hulumtimit të ndërmarrjeve dhe javëve me një praktikë profesionale në ndërmarrje të ndryshme përkrahjet zgjedhja e profesionit.

Lëndët e detyrueshme "gjermanisht", "matematikë" dhe "anglisht" ndahen në grupe rendimentale ose sipas interesave profesionale. Në varësi të interesave profesionale, çdo nxënës/çdo nxënëse zgjedh një nga shtatë specialitete:

- METAL
- ELEKTRICITET
- DRU
- NDËRTIMTARI
- TREGTI-ZYRË
- SHËRBIME
- TURIZËM

Nëpërmjet këtij specialiteti të detyrueshëm në zgjedhje në përmasën prej 15 orëve në javë dhe lëndëve të detyrueshme të përgjithshme në përmasën prej 19 orëve në javë fitohen njohuri dhe aftësi profesionale bazë për aftësimin sa më të plotë për fillimin e përgatitjes profesionale ose vazhdimin e një shkolle më të lartë. Nëpërmjet mundësive strukturore që ofron autonomia e shkollës, çdo shkollë mund të hartojë një ofertë të përshtatshme për zonën dhe interesat e nxënësve.

(Informacione mbi shkollën politeknike në Internet nën:
<http://www.bmbwk.gv.at/pbildg/allgbdg/polys.htm>)

2

SHKOLLAT E MESME TË PËRGJITHSHME

Shkollat e mesme të përgjithshme:

Shkolla e mesme e përgjithshme ka një cikël të ulët prej katër vjetve dhe një cikël të lartë prej katër vjetve dhe mbaron me provimin e pjekurisë.

Nëpërmjet diplomës së provimit të pjekurisë fitohen e drejta e studimeve në universitete, shkolla të larta të specializuara dhe akademi (për disa degë të veçanta mund të jetë e nevojshme dhënia e provimeve plotësuese) si edhe disa të drejta për shërbimin publik.

Hyrja në klasën e 1-rë: Mbarimi i suksesshëm i klasës së 4-të të shkollës fillore (Volksschule); në lëndët "gjermanisht", "lexim" dhe "matematikë" nota "shkëlqyeshëm" (Sehr gut) ose "shumë mirë" (Gut) ose konstatimi i konferencës së shkollës fillore se nxënësi (nxënësja) me gjithë notën "mirë" (Befriedigend) do t'i përballojë me probabilitet të lartë kërkesat e shkollës së mesme të përgjithshme për shkak të realizimeve të tjera; ose provim pranimi.

Hyrja në klasat më të larta:

Nga cikli i lartë i shkollës tetëvjeçare (Hauptschule):

Dëftesë vjetore me "sukses të shkëlqyeshëm" ose shënimin se në vitin tjetër shkollor të ciklit të lartë të shkollës tetëvjeçare (Hauptschule) duhet vazhduar grupi i parë rendimental në lëndët "gjermanisht", "gjuhë e huaj e gjallë" dhe "matematikë". Nota minimale "mirë" (Befriedigend) në lëndët e tjera të detyrueshme; ose provim pranimi.

Pas klasës së 4-të:

Dëftesë vjetore e grupit të parë rendimental (ose nota "shkëlqyeshëm" [Sehr gut] ose "shumë mirë" [Gut] ose "mirë" [Befriedigend] me vendim të konferencës së grupit të dytë rendimental) me notën minimale "mirë" (Befriedigend) në lëndët e tjera të detyrueshme; për ndryshe provim pranimi.

Nga tipet e tjera shkollash:

Në rast nevoje me provim niveli ose pranimi në disa lëndë mësimore.

Tipet e shkollave të mesme të përgjithshme:

(Në vazhdim prezantohen vetëm dallimet kryesore në programin mësimor.)

● *Cikli i ulët (klasa e 1-rë deri në të 4-tën):*

Klasa e 1-rë dhe e 2-të: i njëjti program mësimor në të gjitha tipet; një gjuhë e huaj e gjallë (klasa e 1-rë deri në të 8-tën).

Klasa e 3-të dhe e 4-të: **gjimnazi (Gymnasium)**: latinisht; **gjimnazi real (Realgymnasium)**: vizatim teknik, më shumë matematikë, fizikë; punë teknike ose tekstile; **gjimnazi real ekonomik (Wirtschaftskundliches Realgymnasium)**: më shumë kimi; punë teknike ose tekstile.

● *Cikli i lartë (klasa e 5-të deri në të 8-tën):*

Gjimnazi (Gymnasium):

Latinisht (në vazhdim); përveç kësaj nga klasa e 5-të greqisht ose një gjuhë e huaj e gjallë e dytë.

Gjimnazi real (Realgymnasium):

Më shumë matematikë; plus nga klasa e 5-të latinisht (edhe vazhdimi i latinishtes së filluar në ciklin e ulët të gjimnazit është i mundshëm) ose një gjuhë e huaj e gjallë e dytë; përveç kësaj gjeometri deskriptive ose më shumë biologji dhe njohuri ekologjike, kimi, fizikë.

Gjimnazi real ekonomik (Wirtschaftskundliches Realgymnasium):

Nga klasa e 5-të një gjuhë e huaj e gjallë e dytë ose latinisht. Përveç kësaj: ekonomia shtëpiake dhe ushqimi; më shumë gjeografi dhe njohuri ekonomike, psikologji dhe filozofi (duke përfshirë praktikën).

Gjimnazi real vetëm me ciklin e lartë (Oberstufenrealgymnasium):

Përveç formave tetëvjeçare të shkollës së mesme të përgjithshme ekziston gjimnazi real vetëm me ciklin e lartë (pjesërisht me një vit hyrjeje);

hyrja pas vitit të 8-të shkollor (klasa e 5-të deri në të 8-tën).

Nga klasa e 5-të një gjuhë e huaj e gjallë e dytë ose latinisht. Përveç kësaj mësim instrumental ose krijimtari figurative dhe punë praktike ose gjeometri deskriptive dhe më shumë matematikë ose më shumë biologji dhe njohuri ekologjike, kimi, fizikë (dhe matematikë).

Për të gjithë: Në klasen e 6-të (7-të) deri në të 8-tën duhet të zgjidhen "lëndë të detyrueshme në zgjedhje" në përmasën e përgjithshme prej tetë (gjimnazi, gjimnazi real vetëm me ciklin e lartë), dhjetë (gjimnazi real) ose dymbëdhjetë (gjimnazi real ekonomik) orë në javë.

Format e veçanta: (gjimnazi, gjimnazi real)

● Shkollat e mesme të përgjithshme ku merret parasysh sidomos përgatitja artistike ose sportive

(Nga klasa e 1-rë; gjimnazi real vetëm me ciklin e lartë nga klasa e 5-të, për studiuesit e muzikës: klasa e 5-të deri në të 9-tën); provim aftësimi.

● *Gjimnazi i përshpejtuar ose gjimnazi real i përshpejtuar* (pjesërisht me një vit hyrjeje; klasa e 5-të deri në të 8-tën): Hyrja është e mundshme pa kufi moshe.

● *Gjimnazi, gjimnazi real dhe gjimnazi real ekonomik pa shkëputje nga puna:*

Mësim mbrëmjeje, kohëzgjatja: nëntë semestra. Hyrja pas mbushjes së moshës 17-vjeçare, mbi bazën e njohurive të vërtetuara janë të mundshme edhe fillimi në një semestër më të lartë ose kapërcimi i një ose më shumë semestrave.

● *Gjimnazi federal për sllovenët* (gjuha mësimore është sllovenishtja), vendndodhja: Klagenfurt (gjimnaz dhe gjimnaz real)

● *Gjimnazi federal / Gjimnazi real federal dygjuhësh* (edhe me kroatishen dhe me hungarishten si gjuhë mësimore); vendndodhja: Oberwart

● *Konvikti shkollor i zanateve (Werkschulheim):*

Shkollë e mesme e përgjithshme me përgatitje në një zanat, momentalisht për zdruktartari, mekanikë dhe radiomekanikë/elektronikë (klasa e 1-rë deri në të 9-tën); vendndodhja: Ebenau/ Salzburg.

● *Gjimnaze dhe gjimnaze reale* me mësim të theksuar në gjuhë të huaja (pjesërisht eksperimente shkollore), p. sh. Theresianische Akademie, Europagymnasium, gjuha e huaj e gjallë e 2-të nga klasa e 3-të, 4 gjuhë të huaja të detyrueshme (informacione më të detajuara te këshillat shkollorë të krahinave).

Mbi format e veçanta të tjera të organizuara si eksperiment shkollor (p. sh. me theks kryesor në informatikë, shkencat natyrore; për sportistë për gara) informojnë këshillat shkollorë të krahinave.

Shkollat e mesme me konvikt

Shkolla të mesme të përgjithshme (publike dhe private) me konvikt. Informacione të detajuara mbi shkollat e mesme të federatës me konvikt (vendndodhjet: Vjenë III, Graz, Gmunden, Saalfelden) jepen nga Ministria Federale për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (seksioni I/2).

(Informacione mbi shkollat e mesme të përgjithshme në Internet nën: <http://www.bmbwk.gv.at/pbildg/allgbdg/ahs.htm>)

3

PËRGATITJA E MËSUES(E)VE dhe E EDUKATORËVE (EDUKATOREVE)

(Përjashto: përgatitjen e mësuesve në institute pedagogjike dhe në universitete)

Në akademitë pedagogjike (Pädagogische Akademien) përgatiten mësuesit (mësueset) e shkollave fillore (Volksschulen), të ciklit të lartë të shkollave tetëvjeçare (Hauptschulen), të shkollave speciale dhe të shkollës politeknike.

Mësuesit (mësueset) për lëndën e ekonomisë ushqimore dhe të ekonomisë shtëpiake si edhe mësuesit (mësueset) për lëndët teknike dhe industriale në shkollat e ulëta profesionale (berufsbildende mittlere Schulen) dhe të mesme profesionale (berufsbildende höhere Schulen) si edhe mësuesit (mësueset) për përpunimin e teksteve (përpunim teksti me kompjuter, stenotipi, fonotipi) për të gjitha tipet e shkollave dhe mësuesit (mësueset) e shkollave të detyrueshme profesionale (Berufsschulen) mësojnë profesionin e tyre në akademitë pedagogjike profesionale (Berufspädagogische Akademien). Përgatitja për edukatorë/edukatore kopshti bëhet në institutet arsimore për pedagogjinë e moshës parashkollore dhe për edukatorë/edukatore në nivele të tjera në institutet arsimore për pedagogjinë sociale.

Përveç kësaj ekzistojnë mundësi të veçanta për përgatitjen e mësues(e)ve të shkollave bujqësore dhe pyjore, për mësuesit/mësueset e mësimi fetar dhe për sport.

Kushtet e pranimit dhe kohëzgjatja e studimeve:

Provimi i pjekurisë si kusht pranimi mund të zëvendësohet nga një provim i pjekurisë profesionale ose i autorizimit të studimeve.

● *Mësuesit (Mësueset) e shkollave fillore (Volksschulen), të ciklit të lartë të shkollave tetëvjeçare (Hauptschulen), të shkollave speciale dhe të shkollës politeknike:* provimi i pjekurisë i një shkolle të mesme ose provimi i pjekurisë profesionale dhe dëshmia e aftësisë fizike; kohëzgjatja e përgatitjes: 6 semestra.

● *Mësuesit (Mësueset) për lëndën e ekonomisë ushqimore dhe të ekonomisë shtëpiake:* provimi i pjekurisë ose provimi i pjekurisë profesionale; kohëzgjatja e përgatitjes: 6 semestra (semestri i 1-rë deri në të 2-tin: praktikë profesionale e shoqëruar nga studimet teorike, semestri i 3-të deri në të 6-tin: studime me program të plotë).

● *Mësuesit (Mësueset) për lëndët teknike dhe industriale (mësim teorik) në shkollat e ulëta profesionale (berufsbildende mittlere*

Schulen) dhe mësuesit (mësueset) e shkollave të detyrueshme profesionale (Berufsschulen) (mësim teorik): provimi i pjekurisë në degën përkatëse ose provimi i pjekurisë bashkë me mbarimin e mësimit të profesionit dhe një praktikë profesionale; kohëzgjatja e përgatitjes: gjashtë semestra (semestri i 1-rë deri në të 4-tin: praktikë mësimore e shoqëruar nga seminare të ndryshme, semestri i 5-të deri në të 6-tin: studime me program të plotë).

● *Mësuesit (Mësueset) për lëndët teknike dhe industriale (mësim praktik) në shkollat e ulëta profesionale (berufsbildende mittlere Schulen) dhe të mesme profesionale (berufsbildende höhere Schulen) dhe mësuesit (mësueset) e shkollave të detyrueshme profesionale (Berufsschulen) (mësim praktik): provimi i kualifikimit si mjeshtër ose një përgatitje me të njëjtën vlerë; kohëzgjatja e përgatitjes: gjashtë semestra (semestri i 1-rë deri në të 4-tin: praktikë mësimore e shoqëruar nga seminare të ndryshme, semestri i 5-të deri në të 6-tin: studime me program të plotë).*

● *Mësuesit (Mësueset) për përpunimin e teksteve (përpunim teksti me kompjuter, stenotipi, fonotipi): provimi i pjekurisë; kohëzgjatja e përgatitjes: gjashtë semestra (semestri i 1-rë deri në të 2-tin: praktikë profesionale e shoqëruar nga studimet teorike, semestri i 3-të deri në të 6-tin: studime me program të plotë).*

● *Mësuesit (Mësueset) e shkollave bujqësore dhe pyjore: provimi i pjekurisë i një shkolle të mesme bujqësore ose pyjore ose provimi i pjekurisë profesionale me profil bujqësor: kohëzgjatja e përgatitjes katër semestra; mbarimi i Universitetit të Agronomisë: kohëzgjatja e përgatitjes një semestër.*

● *Edukatorët (Edukatoret) e kopshteve me mundësinë e përgatitjes plotësuese për edukatorë/edukatore strehe ditore për fëmijë shkolle: mbarimi pozitiv i vitit të 8-të shkollor, provim aftësimi, kohëzgjatja e studimeve: pesë vjet; mbarimi: provim pjekurie dhe diplome me autorizimin për të studiuar në universitete dhe akademi. Për absolventët (absolventet) e provimit të pjekurisë, të autorizimit të studimeve dhe të pjekurisë profesionale organizohen kurse parauniversitare dyvjeçare.*

● *Edukatorët (Edukatoret) e strehëve ditore për fëmijët e shkollës dhe e konvikteve për fëmijë dhe të rinj si edhe në punën jashtëshkollore me të rinjtë: mbarimi pozitiv i vitit të 8-të shkollor, provim aftësimi; kohëzgjatja e studimeve: pesë vjet; mbarimi: provim pjekurie dhe diplome me autorizimin për të studiuar në universitete dhe akademi. Për absolventët (absolventet) e provimit të pjekurisë, të autorizimit të studimeve dhe të pjekurisë profesionale organizohen kurse parauniversitare dyvjeçare.*

● *Shkolla e Lartë për Profesione Pedagogjike:*

Sipas Ligjit mbi studimet në akademitë nga viti 1999 (Fletorja zyrtare federale I nr. 94/1999) do të krijohen brenda tetë vjetve disa institucione në nivelin e shkollave të larta ("Shkolla e Lartë për Profesione Pedagogjike"), fusha e kompetencës së të cilave do të përfshijë ndër të tjera përgatitjen e mësuesve të shkollave të detyrueshme si edhe të mësuesve të sistemit të formimit për të rriturit. Këto shkolla të larta do të zëvendësojnë më vonë akademitë pedagogjike.

Informacione mbi përgatitjen e mësues(e)ve dhe të edukatorëve (edukatoreve) në Internet nën:

<http://www.bmbwk.gv.at/pbildg/allgbdg/lehraus.htm>

4

SHKOLLAT E DETYRUESHME PROFESIONALE SHKOLLAT E ULËTA PROFESIONALE

Shkollat e detyrueshme profesionale (shkollat profesionale)

ua japin çirakëve nëpërmjet një mësimi profesional shoqëruar gjatë përgatitjes së tyre në një zanaat njohuritë teorike bazë; ato nxisin dhe plotësojnë përgatitjen në ndërmarrje dhe kulturën e përgjithshme. Mësimi i teorisë së profesionit përkatës dhe i biznesit jepet në dy grupe rendimentale. Shkolla ndiqet ose në jo më pak se një ditë në çdo javë të vitit shkollor ose në formë të një kursi jo më pak se tetëjavësh në çdo vit shkollor. Numri i vjetve shkollorë varet nga kohëzgjatja e përgatitjes në zanaat.

Në kuadrin e një "çirakllëku paraprak" mund t'u jepen të rinjve me një përgatitje shkollorë të pamjaftueshme përmbajtjet e vitit të parë të përgatitjes në dy vjet.

Shkollat e ulëta profesionale (Berufsbildende mittlere Schulen)

zgjasin 1 deri në 4 vjet. Shkollat e ulëta profesionale me një kohëzgjatje të përgatitjes prej 1 ose 2 vjetve japin një përgatitje profesionale pjesërisht, ato me një kohëzgjatje të përgatitjes prej 3 ose 4 vjetve një plotësisht të kryer.

Pranimi:

Për t'i ndjekur, i interesuari duhet të ketë mbaruar me sukses vitin e 8-të shkollor në një shkollë fillore (Volksschule), në ciklin e lartë të një shkolle tetëvjeçare (Hauptschule) ose në një shkollë të mesme të përgjithshme (përfshijë latinishten, vizatimin teknik dhe lëndët e detyrueshme me theks të veçantë).

Përveç kësaj është e nevojshme për pranimin në një shkollë të ulët profesionale me një kohëzgjatje prej jo më pak se tre vjetve që nxënësi (nxënësj) i (e) klasës së 4-të të ciklit të lartë të një shkolle tetëvjeçare (Hauptschule) të japë një provim pranimi në lëndët "gjermanisht", "anglisht" ose "matematikë", në qoftë se ai (ajo) ka qënë në grupin rendimental më të ulët në lëndën përkatëse. Pas mbarimit të suksesshëm të një shkolle politeknike ky provim pranimi nuk është i nevojshëm. Për ndjekjen e një shkolle të ulët profesionale me kërkesa të veçanta nga pikëpamja artistike dhe sportive dhënia e një provimi të aftësisë është patjetër e domosdoshme.

Hyrja në një klasë më të lartë është e mundshme pas dhënies së një provimi për përcaktimin e nivelit ose pranimi, kalimi nga klasa e 1-rë në vitin e II-të të shkollës së mesme përkatëse bëhet në përgjithësi pa provim.

Të drejtat që fitohen:

Absolventët (Absolventet) e shumicës së shkollave profesionale së paktën trevjeçare mund të fillojnë të ushtrojnë profesione dhe/ose zanate me kufizime ligjore. Volumi i veprimtarisë së specializuar si edhe kërkesat e provimeve përcaktohen nga rregulloret përkatëse mbi vërtetimin e aftësisë.

Pas kryerjes së shumë shkollave të ulëta së paktën trevjeçare, kurse plotësuese (me katër deri në gjashtë semestra) çojnë derin në provimin e pjekurisë dhe të diplomës.

Shkollat e ulëta profesionale kryesore:

● *Shkollat teknike, industriale dhe artizanale* (në shumicën e rasteve katërvjeçare).

Degët kryesore: makineri, elektroteknikë, elektronikë, mekanikë precizioni, teknikë ndërtimi, kimi, tekstil, dru, qelq, teknikë shtypi, profesione grafike; degë artizanale dhe artistike.

● *Shkolla tregtare* (trevjeçare): përgatitje për profesionet e të gjitha degëve të ekonomisë dhe të administratës. (Eksperiment shkollor: shkolla tregtare për teknologjinë e informacionit; forma të veçanta katërvjeçare: për sportistë garash, për skijatorë).

● *Shkollat e tjera komerciale*: Shkollë dyvjeçare për punonjës zyre dhe trajtimin e të dhënave. Shkollë për trajtimin elektronik të të dhënave (dyvjeçare), shkollë për tregtarë të pajisjeve informatike (trevjeçare).

● *Shkolla për profesione ekonomike* (trevjeçare): përgatitje në profesione ekonomike dhe turistike me mundësi zgjedhjeje të këtyre specialiteteve kryesore: organizimi i ndërmarrjeve dhe drejtimi ekonomik, ekonomia ushqimore dhe biznesi, shëndetësia dhe çështje sociale, ekologjia humane, turizmi kulturor ose gjuhë të huaja. (Eksperiment shkollor katërvjeçar me përgatitje sportive plotësuese.)

● *Shkolla e ekonomisë shtëpiake* (dyvjeçare), shkolla për drejtimin e punëve të shtëpisë (njëvjeçare) ose eksperimenti shkollor i shkollës ekonomike (një ose dyvjeçare): përgatitje në drejtimin e punëve të shtëpisë. Punët e guzhinës dhe të shërbimit në hoteleri dhe gastronomi, përgatitje paraprake për shkollën e infermierëve.

● *Shkolla e modës dhe e teknikës së veshmbathjes* (një ose dyvjeçare): përgatitje për specialistë të industrisë së veshmbathjes (drejtimet kryesore të përgatitjes në zgjedhje: teknika e veshmbathjes, studio mode, disenjo mode).

● *Shkolla e hotelarisë, shkolla e turizmit* (trevjeçare): përgatitje për specialistë të hotelarisë dhe të gastronomisë ose të administratës së qendrave kurative dhe të turizmit (drejtimet kryesore të përgatitjes në zgjedhje: gastronomi, sport, gjuhë të huaja).

● *Shkolla për profesione sociale*: Shkolla 3-vjeçare për profesione sociale, shkolla e shërbimeve sociale (dyvjeçare). Shkollat e tjera për profesione sociale (pranim vetëm në një moshë më të madhe): Shkolla e shërbimeve për pleqët dhe për ndihmën në përkujdesje, shkolla për ndihmën familjare, shkolla e përkujdesjes sociale, instituti i profesioneve të pedagogjisë kurative.

● *Shkollat bujqësore dhe pyjore*

(Kohëzgjatja e përgatitjes nga dy deri në katër vjet shkollorë):

Përgatitje në specialitetet bujqësi, kopshtari, vreshtari, duke përfshirë qilarët, pemëtari, ekonomi bujqësore shtëpiake, përpunim qumështi, prodhim djathi, teknikë bujqësore dhe pyjore etj.

Informacione më të detajuara jepen nga seksionet arsimore për bujqësinë pranë qeverive të krahinave.

● *Shkollat për përkujdesjen e shëndetësisë dhe për infermierë*: Shkollat dhe kurset me këtë profil organizohen me miratimin e Ministrisë Federale të Sigurisë Sociale dhe të Brezave ose në bashkëpunim me spitalet. Për informacione më të detajuara shih broshurën "Bildungswege im helfenden Bereich" (Drejtimet arsimore në fushën e shërbimeve ndihmëse)

(Internet: <http://www.schulpsychologie.at/download/bwhelf.pdf>)

5

SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE

Shkollat e mesme profesionale

japin brenda pesë vjetve jo vetëm një kulturë të përgjithshme me themel, por edhe një përgatitje të mirë profesionale; ato kryhen me një provim pjekurie dhe diplome, nëpërmjet të cilit fitohen e drejta e studimeve në universitete (për disa degë mund të jetë e nevojshme kryerja e provimeve shtesë), në kurse të shkollave të larta të specializuara (në këtë rast mund të parashikohet llogaritja e njohurive të vërtetuara për absolventët [absolventet] e shkollave të mesme profesionale përkatëse që mund të shkaktojë një shkurtim të studimeve deri në dy semestra) dhe në akademi si edhe disa të drejta për shërbimin publik.

Për shkak të përgatitjes profesionale në shkollë rruga është e hapur edhe për zanate të ndryshme (për ushtrimin e pavarur të profesioneve me kufizime ligjore). Provimet e mundshme për vërtetimin e aftësisë dhe kohëzgjatja e veprimtarive përkatëse që duhet vërtetuar rregullohen nëpërmjet rregullores përkatëse mbi vërtetimin e aftësisë. Absolventët (absolventet) e shumë instituteve të mesme teknike dhe industriale si edhe bujqësore dhe pyjore kanë mundësinë, pas një veprimtarie përkatëse dyvjeçare, të ushtrojnë një zanat të të njëjtit profil pa dhënë provimin e kualifikimit për mjeshtër. Përveç kësaj, absolventët (absolventet) e instituteve të mesme teknike ose të mesme bujqësore dhe pyjore kanë mundësinë, nëpërmjet një kërkesë të drejtuar Ministrisë Federale për Çështje Ekonomike ose Ministrisë Federale të Bujqësisë dhe të Ekonomisë Pyjore pas tre vjetve të praktikës profesionale, të mbajnë emërtimin profesional "inxhinier".

Pranimi:

Shkollat e mesme profesionale mund të ndiqen nga nxënësit (nxënëset) që kanë kryer me sukses klasën e 4-të të ciklit të lartë të shkollës tetëvjeçare (Hauptschule), klasën e 4-të ose një klasë më të lartë të shkollës së mesme të përgjithshme ose vitin e 9-të shkollor në shkollën politeknike (përfashto latinishten, vizatimin teknik dhe lëndët e detyrueshme me theks të veçantë). Një nxënës(e) i (e) klasës së 4-të të ciklit të lartë të një shkolle tetëvjeçare (Hauptschule) duhet të japë një provim pranimi për lëndët "gjermanisht", "anglisht" ose "matematikë", në qoftë se ai (ajo) ka qënë në lëndën përkatëse në grupin rendimental më të ulët ose është vlerësuar në grupin rendimental të mesëm me "mjaftueshëm" (Genügend); me notën "mirë" (Befriedigend) në grupin rendimental të mesëm pranimi është i mundshëm me vendim të konferencës së klasës. Në shkollat e mesme profesionale me drejtim artistik duhet të jepet një provim aftësimi.

Shkollat e mesme profesionale kryesore:

● *Institetet e mesme teknike dhe industriale:* përgatitje në profesione teknike, industriale dhe artizanale.

Degët: teknikë ndërtimi, krijim interioresh dhe teknikë druri, elektroteknikë, elektronikë, ekonomi druri, kimi tekstile, makineri, mekatronikë, teknikë materialesh, teknikë mediash dhe manaxhimi i masmediave, kimi, teknikë kimike, teknologji ushqimore, trajtim elektronik i të dhënave dhe organizim, teknikë ekonomike, manaxhimi i ndërmarrjeve, art dhe diseno, diseno tekstilesh, diseno artistike, diseno figurative, fotografi dhe mjete vizuale.

● *Instituti i mesëm i modës dhe i teknikës së veshmbathjes dhe Instituti i mesëm për diseno mode dhe diseno prodhimesh:* përgatitje për specialistë të kualifikuar të industrisë së veshmbathjes.

● *Instituti i mesëm për turizëm:*

përgatitje për specialistë të kualifikuar të turizmit. (Drejtimet kryesore të përgatitjes në zgjedhje: gjuhë të huaja, manaxhimi i hoteleve, manaxhim turistik, dëfrim kulturor, turizëm urban dhe manaxhimi i ngjarjeve.)

● *Akademia tregtare:*

përgatitje për ushtrimin e profesioneve të nivelit të mesëm në të gjitha degët e ekonomisë dhe të administratës, në zgjedhje me këto drejtime kryesore: marketing dhe afarizëm ndërkombëtar, kontroll dhe bilanc vjetor, informatikë ekonomike dhe organizimi i ndërmarrjeve. Eksperimente shkollore me drejtimin kryesor manaxhim informacioni dhe teknologji informacioni, manaxhim logjistik dhe ekonomi spedicionesh si edhe ekonomi ndërkombëtare.

● *Instituti i mesëm për profesione ekonomike:*

përgatitje për specialistë të kualifikuar në profesione ekonomike dhe turistike, në zgjedhje me këto drejtime kryesore: organizimi i ndërmarrjeve dhe drejtimi ekonomik, ekonomia ushqimore dhe biznesi, gjuhë të huaja, shëndetësia dhe çështje sociale, ekologjia humane, turizmi kulturor, manaxhimi kulturor dhe i kongreseve, mjedisi dhe ekonomia, informatikë mediash, administrim social ose ekonomia ekologjike. Eksperimente shkollore me drejtimet kryesore manaxhimi i prodhimeve dhe prezantim, manaxhim social si edhe Evropë.

● *Instituti e mesme bujqësore dhe pyjore:*

përgatitje për specialistë të kualifikuar në bujqësi dhe në ekonominë pyjore. *Degët: bujqësia e përgjithshme, bujqësia e Alpeve, teknikë bujqësore, kopshtari, vreshtari dhe pemëtari, ekonomia pyjore, ekonomia e qumështit dhe teknologjia ushqimore, bujqësia dhe industria ushqimore.*

(Informacione mbi sistemin e arsimit profesional në Internet: <http://www.berufsbildendeschulen.at>)

6

KURSET PARAUNIVERSITARE – AKADEMITË – SHKOLLAT E LARTA TË SPECIALIZUARA – UNIVERSITETET

Kusht për pranimin është provimi i pjekurisë, provimi i pjekurisë profesionale ose provimi i autorizimit të studimeve.

Kurset parauniversitare

Përgatitje profesionale dyvjeçare (trevjeçare pa shkëputje nga puna) e një niveli të shkollave ose instituteve të mesme profesionale.

Degët: teknikë ndërtimi, kimi, trajtim elektronik i të dhënave dhe organizim, elektronikë, elektroteknikë, pedagogji për kopshtet e fëmijëve, pedagogji sociale, teknikë precizioni, ndërtim mobiljesh dhe projektim interioresh, disenjo interioresh dhe teknikë druri, teknikë shtypi dhe mediash, fotografi dhe mjete vizuale, disenjo grafike, multimedia, kurs parauniversitar pranë akademive tregtare, kurs parauniversitar për profesione ekonomike, disenjo artizanale, makineri, teknikë impjantesh dhe planifikim energjitik, teknika ekonomike, "facility management", teknika e lëndëve plastike, moda dhe teknikë veshmbathjeje, disenjo tekstile, turizmi dhe ekonomia e kohës së lirë.

Akademitië

Përgatitje profesionale trevjeçare në fushën e mësimdhënies, të punës sociale dhe të shëndetësisë.

- *Akademia për punonjës të sistemit social:*

përgatitje për punonjës(e) të diplomuar(a) të sistemit social.

- *Akademitië për shërbimet e sistemit shëndetësor:*

Këto akademi organizohen me miratimin e Ministrisë Federale të Sigurisë Sociale dhe të Brezave pranë spitaleve. Drejtimet: shërbim laboratorik teknik mjekësor, shërbim psikoterapeutik, shërbim teknik radiologjik, shërbim dietetik dhe konsultativ mjekësor ushqimor, shërbim ergoterapeutik, shërbim logopedik, foniatrik, audiologjik, shërbim ortopedik, akademija e mamive.

- *Akademia pedagogjike, akademija e pedagogjisë profesionale dhe akademija e pedagogjisë fetare* shih kapitullin 3 përgatitja e mësues(e)ve.

Kurset e shkollave të larta të specializuara

Përgatitje profesionale me themel shkencor e orientuar shumë sipas profesioneve (në shumicën e rasteve 1 semestër praktik). Kohëzgjatja: në përgjithësi 8 semestra (4 vjet).

Momentalisht organizohen në Austri kurse të shkollave të larta të specializuara në këto degë: teknikë, ekonomi, turizëm, media, disenjo, mbrojtje, puna sociale dhe manaxhimi i shëndetësisë. Titulli shkencor që mund të fitohet: "Magister (FH)" ose "Dipl.-Ing. (FH)". Për studimet në shkollat e larta të specializuara mund të pranohen edhe persona me një kualifikim profesional relevant për studimet, por pa provim pjekurie (në shumicën e rasteve me një provim shtesë).

(Informacione në Internet nën:

<http://www.bmwf.gv.at/2studinf/02fachh/>)

Studimet universitare

- *Studimet e diplomës*

shërbejnë në radhë të parë për një përgatitje profesionale me themel shkencor dhe artistik dhe zgjasin në përgjithësi tetë deri në njëmbëdhjetë semestra. Me kryerjen e studimeve fitohet e drejta e mbajtjes së titullit përkatës (p. sh. Mag., Dipl.-Ing.) (Përfundim: Studimet e mjekësisë mund të kryhen vetëm me titullin "doktor".) Studimet e diplomës përbëhen në përgjithësi nga dy faza që kryhen secila me një provim diplome. Ka drejtime në fushën e shkencave humane dhe kulturore, të inxhinierisë, drejtime artistike, studime për t'u bërë mësues në shkollat e mesme (gjithëmonë për dy lëndë mësimore), drejtime në fushën e mjekësisë, të shkencave natyrore, juridike, sociale dhe ekonomike si edhe drejtime teologjike.

- *Bakalaureati:*

Një amendament i ligjit mbi studimet universitare që ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 1999 krijon mundësinë e strukturimit të studimeve diplome të deritanishme në studimet e bakalaureatit me një kohëzgjatje nga 3 deri në 4 vjet dhe mbi bazën e tyre në studimet për magjistrë me një kohëzgjatje nga 1 deri në 2 vjet. Studimet e bakalaureatit vetë shërbejnë për një përgatitje profesionale dhe kualifikim shkencor ose artistik. Mbarimi njihet si diplomë universitare evropiane (sipas direktivës 89/98 EWG - përgatitje profesionale passekundare së paktën trevjeçare).

- *Studimet e doktoraturës:*

bazohen mbi studimet e diplomës, të magjistratit ose të shkollave të larta të specializuara dhe shërbejnë kryesisht për zhvillimin e mëtejshëm të aftësisë për punën shkencore të pavarur. Mbarimi jep të

drejtën e fitimit të titullit doktor në degën përkatëse. Kohëzgjatja është 1 deri në 2 vjet, për absolventët e shkollave të larta të specializuara gjithëmonë një vit më shumë.

(Informacione në Internet:

<http://www.bmwf.gv.at/3uniwes/index.htm>)



SHKOLLAT PA SHKËPUTJE NGA PUNA – ARSIMI PËR TË RRRITURIT – KONSULTORJA E ARSIMIT

Shkollat pa shkëputje nga puna

Personat që janë futur në jetën profesionale ose që kanë mbaruar një përgatitje profesionale kanë mundësinë që krahas veprimtarisë së tyre profesionale të marrin në formë të mësimit të mbrëmjes një kualifikim më të lartë.

Ekzistojnë shkolla të mesme të përgjithshme dhe profesionale pa shkëputje nga puna, kurse të përsheptuara, kurse parauniversitare, akademi dhe kurse në shkollat e larta të specializuara.

Arsimi për të rriturit

Institucionet e arsimit për të rriturit, si shkollat e larta popullore, institutet e nxitjes profesionale, institutet e nxitjes ekonomike, institucione rajonale dhe fetare, ofrojnë kurse dhe programe jo vetëm të kulturës së përgjithshme, por edhe të arsimit profesional.

Përveç kësaj, sistemi i arsimit për të rriturit ka funksionin e mundësimin të mbarimit të shkollave të ndryshme më vonë në kuadrin e një "kariere të dytë arsimore". Në institucionet e sistemit të arsimit për të rriturit, të interesuarit mund të marrin pjesë në kurse përgatitore për maturën, për provimin e autorizimit të studimeve, për provimin e pjekurisë profesionale dhe për mbarimin e ciklit të lartë të shkollës tetëvjeçare.

Informacione të detajuara jepen nga Ministria Federale për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, seksioni i arsimit për të rriturit V/15, tel.: 01/531 20/4631.

(Informacione në Internet: <http://www.erwachsenenbildung.at>)

Konsultorja e arsimit

Institucione ose persona që ndihmojnë për marrjen e vendimeve në fushën e arsimit:

● *Konsultorja e psikologjisë shkollore dhe e arsimit:* 77 zyra në Austri (për qendrat e krahinave shih faqen tjetër)

● *Këshilltari (Këshilltarja) i (e) nxënësve dhe i (e) arsimit:* mësues(e) me një përgatitje përkatëse në çdo shkollë nga viti i 5-të shkollor.

● *Qëndrat e shërbimeve për nxënësit* në të gjithë këshillat shkollorë të krahinave dhe në Ministrinë Federale për Arsim, Shkencë dhe Kulturë.

● *Qëndrat e informimit profesional:* të organizuara në të gjitha krahinat nga Zyra e Punës ose nga Dhoma e Tregtisë.

Informacione të tjera të Konsultores së psikologjisë shkollore dhe të arsimit me këshilla për arsimin dhe shumë lidhje të shkolla dhe institucione të ndryshme gjinden në Internet nën adresën:

<http://www.schulpsychologie.at>

**Ministria Federale për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, seksioni V/4
(Konsultorja e psikologjisë shkollore dhe e arsimit)
1014 Vjenë, Freyung 1, tel.: 01/531 20
e-mail: schulpsychologie@bmbwk.gv.at
Homepage: <http://www.schulpsychologie.at>**

MinRat Mag. DDr. Franz Sedlak, numri i brendshëm: 2580

ORat Dr. Gerhard Krötzl, numri i brendshëm: 2582

MinRat Dr. Harald Aigner, numri i brendshëm: 2581

ADir. Susanna Herdin, numri i brendshëm: 2583

Broshura mund të porositet te:

Renate Preis, numri i brendshëm: 2584

**Konsultorja e psikologjisë shkollore dhe e arsimit pranë
këshillave shkollore të krahinave (këshillit shkollor të qytetit)**

Burgenland:

7001 EISENSTADT, Kernausteig 3,

tel.: 02682/710-131

Kärnten:

9020 KLAGENFURT, Kaufmannngasse 8,

tel.: 0463/566 59

Austria e Poshtme:

3109 ST. PÖLTEN, Rennbahnstraße 29,

tel.: 02742/280-4702

Austria e Siperme:

4041 LINZ, Sonnensteinstraße 20,

tel.: 0732/7071-2321

Salzburg:

5010 SALZBURG, Rudolfskai 48,

tel.: 0662/84 27 88

Steiermark:

8015 GRAZ, Körblergasse 23,

tel.: 0316/345-199

Tirol:

6020 INNSBRUCK, Müllerstraße 7,

tel.: 0512/57 65 61

Vorarlberg:

6900 BREGENZ, Bahnhofstraße 10/2,

tel.: 05574/4960

Vjenë:

1013 VJENË, Wipplingerstraße 28,

tel.: 01/52 525-77 505

Botuesi dhe pronari: Seksioni i konsultores së psikologjisë shkollore dhe të arsimit në
Ministrinë Federale për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, 1014 Vjenë
Shtypshkronja: Eugen Ketterl Gesellschaft m.b.H., 3001 Mauerbach
Përkthimi i tirazhit të 26-të, 2002